

6 Nëntor 2014, Prishtinë

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Diskutimet publike për planet urbane në Prishtinë duhet të jenë gjithëpërfshirëse

Që nga qershori i këtij viti, Komuna e Prishtinës ka filluar me organizimin e diskutimeve publike për hartimin/revidimin e planeve rregulluese të lagjeve të Prishtinës. Deri më tani janë organizuar disa diskutime të tilla publike. EC Ma Ndryshe, në kuadër të projektit “Online Transparency”, ka marrë pjesë në disa prej këtyre diskutimeve publike në cilësinë e organizatës monitoruese.

EC Ma Ndryshe ka vërejtur disa mangësi në lidhje me organizimin e këtyre diskutimeve. Mënyra e njoftimit të qytetarëve dhe targetimi jogjithëpërfshirës i grupeve të komunitetit ka prodhuar diskutime publike me mbi 90% pjesëmarrës të gjinisë mashkullore. Gjithashtu, në këto takime janë artikuluar vërejtje edhe nga vetë qytetarët për mënyrën e organizimit dhe përfshirjen e grupeve.

Përfshirja e të gjitha grupeve të komunitetit në procesin e hartimit të planeve urbane është kusht elementar i qeverisjes demokratike. Në veçanti, ky proces duhet të krijojë hapësirë për grupet e komunitetit që jetojnë të privuar nga infrastruktura dhe shërbimet adekuate publike. Planifikimi urban duhet të jetë proces gjithëpërfshirës, ku komuna duhet të gjejë mënyra për t’u siguruar që grupet e komunitetit, e sidomos ato të nënpërfaqësuar, janë pjesë e hartimit të planeve urbane në të gjitha fazat.

Andaj, duke u nisur nga kjo, si dhe nga të gjitha parregullsitë që i kanë shoqëruar këto diskutime publike të deritanishme, EC Ma Ndryshe, me qëllim të rritjes cilësore të pjesëmarrjes qytetare në hartimin e planeve urbane, rekomandon që:

- Komuna të bashkëpunojë me organizatat e shoqërisë civile (sidomos organizatat e komunitetit) për organizimin dhe fasilitimin e diskutimeve publike rreth planeve urbane, edhe pse me ligjin për planifikimin hapësinor të Kosovës, përgjegjësia për organizimin e diskutimeve publike në lidhje me planet hapësinore i takon autoriteteve (lokale dhe qendrore),
- Rëndësi e veçantë t’i kushtohet targetimit të grupeve të komunitetit për t’u siguruar në pjesëmarrje sa më të gjerë dhe të barabartë në procesin e hartimit të planeve urbane. Diskutimet publike të zhvillohen në grupe të vogla (15-20 vetë) brenda grupeve të caktuara të komunitetit (gratë, të rinjtë, personat me nevoja të veçanta, të moshuarit, lagjet informale, ambientalistët, artistët, etj.). Brenda këtyre grupeve, komponenta e barazisë gjinore dhe e qasshmërisë për personat me nevoja të veçanta të konsiderohen si prioritete primare,
- Të sigurohet që ftesa të shpërndahet minimum 8 ditë përpara mbajtjes së diskutimeve publike (duke e respektuar afatin kohor të caktuar me ligjin për planifikim hapësinor),

- Ftesa e këtyre komuniteteve do të bëhet përmes mënyrave që tashmë komuna i përdorë (kopje fizike tek dyert e banesave; format A4 apo A3 të ngjitura në hyrje të banesave; shpallje në medie) por edhe ftesë përmes SMS-ve dhe e-mailave; përmes organizatave të komunitetit tek anëtarësitë e tyre dhe platformave të medieve sociale,
- Bashkë me ftesën për diskutimin publik, të shpërndahej një përmbledhje tekstuale dhe grafike (1 fq. A4) mbi planin urban në diskutim. Në web-faqen e komunës, para diskutimit të publikohet përmbledhja grafike dhe tekstuale e lagjes dhe propozimit për të (varësisht prej fazës së planifikimit që do të diskutohet),
- Para diskutimit, përveç në mënyrë grafike e tekstuale, të prezantohet edhe me anë të maketave të një shkallë të lexueshme, lagjja, vizioni dhe intervenimi i propozuar (varësisht prej fazës së planifikimit që vihet në diskutim),
- Përzgjedhja e kompanisë/studios/arkitektëve-urbanistëve që do të marrin përsipër planifikimin hapësinor të një lagjeje/zone, të jetë transparente. Procesi të jetë i qasshëm për publikun (përmes ekspozitës së propozimeve apo ngjashëm), që qytetarët të kenë mundësinë e shprehjes së mendimit për këto propozime,
- Diskutimet publike të realizohen në dy forma: Diskutimi plenar (një në fillim të fazës planifikuese dhe një në përmblyllje) dhe diskutimi në formën e tryezës së rrumbullakët (të ndarë në grupe të komunitetit). Gjatë organizimit të diskutimit, të gjithë pjesëmarrësit duhet të jenë ulur në plan të barabartë diskutimi,
- Përveç takimeve të drejtpërdrejta me qytetarët, drafti i planit urban (pjesa grafike dhe tekstuale) të vendosen në web-faqen e komunës, për t'u ofruar mundësi komentimi qytetarëve që nuk kanë mundësi të jenë prezent fizikisht në diskutimet publike.

Të gjitha këto veprime janë parakushte bazike për të siguruar proces gjithëpërfshirës dhe demokratik të planifikimit urban në komunën e Prishtinës. Planifikimi urban është procesi më i ndjeshëm i vendimmarrjes komunale që ndikon drejtpërdrejtë në cilësinë e jetesës së qytetarëve.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së komunës së Prishtinës do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prishtinës do të publikohen në ueb-faqen e projektit, www.online-transparency.org.

Ju falemnderit,
 arch. Rozafa Basha, koordinatore projekti
 OJQ EC Ma Ndryshe



British Embassy
 Pristina

*Projekti "Transparenca Online e komunave të Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës"
 përkrahjet financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.*